



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDES: MENAXHIMI BASHKËKOHOR

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi Bashkëkohor
Niveli:	Doktoratë
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	45 h
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri dimëror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kursi ofron njohuri të avancuara në teoritë, praktikat dhe sfidat moderne në menaxhim. Ky kurs është projektuar për studentët e doktoraturës që dëshirojnë të zhvillojnë një kuptim të thellë, të drejtuar nga kërkimi i paradigmes në zhvillim të menaxhimit dhe udhëheqjes. Ai mbulon një gamë të gjerë temash që pasqyrojnë gjendjen aktuale të mjedisit të biznesit, duke theksuar si aspektet teorike ashtu edhe ato praktike të menaxhimit. Kursi për studentët e doktoraturës eksploron teoritë e avancuara të menaxhimit, metodologjitë e kërkimit dhe praktikat që janë shfaqur në përgjigje të mjedisit global të biznesit që ndryshon me shpejtësi. Kursi synon të nxisë të menduarit kritik dhe të inkurajojë zhvillimin e njohurive të reja që mund të aplikohen në sfidat e menaxhimit në një sërë kontekstesh organizative. Kursi pajis ata me njohuritë, aftësitë e të menduarit kritik dhe mjetet metodologjike të nevojshme për të kontribuar në njohuri të reja në fushën e menaxhimit dhe për të ndikuar si në mendimin akademik ashtu edhe në praktikën menaxheriale.
Qëllimet e lëndës:	1. Ky kurs është dizenuar që të synoj dhe ndjek karrierë në qeversije biznesesh, akademi, këshillim ose role të nivelit të lartë të korporatës, veçanërisht në fushat e udhëheqjes strategjike, inovacionit dhe menaxhimit organizativ. 2. Ai siguron njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të kryer kërkime me ndikim të lartë, për të kontribuar në diskursin akademik dhe për të ndikuar në praktikat

	bashkëkohore të menaxhimit.		
	3. Kursi ndërthur teorinë me njohuri praktike, duke i përgatitur studentët për të udhëhequr dhe për të inovuar në një mjedis biznesi global gjithnjë në ndryshim.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti është në gjendje të: • Zhvillon aftësi të avancuara kërkimore dhe të nevojshme për të kontribuar në fushën e menaxhimit përmes kërkimit rigoroz dhe origjinal akademik; • Nxit të menduar dhe analiza kritike se si të vlerësojnë në mënyrë kritike teorinë, praktikën dhe tendencat e menaxhimit; • Udhëheq dhe orientojnë strategjikisht drejt zhvillimit të një kuptimi të thellë të dinamikës së lidershipit dhe proceseve të vendimmarrjes strategjike në organizatat bashkëkohore; • Përgatit studentët për akademi ose industri duke pajisur ata me njohuritë dhe mjetet për të ndjekur karrierën akademike ose pozicionet drejtuese në organizata; • Vlerëson në mënyrë kritike ndikimin e tendencave në zhvillim (teknologji, globalizim, qëndrueshmëri) në praktikën organizative; • Kontribuon në kërkime origjinale në fushën e menaxhimit, duke përdorur metodologji dhe korniza të përshtatshme; • Komunikon konceptet komplekse të menaxhimit në mënyrë të qartë dhe efektive, si teorike ashtu edhe praktike; • Zhvillon dhe mbron strategji të bazuara në kërkime për adresimin e çështjeve bashkëkohore të biznesit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	9	27
Leximi i literaturës shkencore	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	9	18
Esetë dhe grupet e diskutimit	2	5	10
Përgatitja për provimin final	4	5	20
Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave	3	5	15
Analiza e të dhënave dhe hartimi i punimit hulumtues	5	5	25

Rishikimi/kontrollimi i punimit dhe përgaditja për prezentim	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies për lëndën "Menaxhimi Bashkëkohor" në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi bazohet në një qasje të kombinuar teoriko-praktike, e cila synon të pajisë studentët me aftësi të thelluara për Biznes dhe Ekonomi: 1. Ligjërata: Bazat teorike dhe diskutimi i koncepteve kryesore; 2. Seminare: Diskutim i thelluar i punimeve të fundit kërkimore, rasteve studimore dhe tendencave aktuale; 3. Punëtori: Aktivitete bashkëpunuese të fokusuara në zhvillimin e propozimeve kërkimore, metodologjive dhe aplikimeve praktike; 4. Projektet hulumtuese: Studentëve të doktoraturës mund t'u kërkohet të ndërmarrin një projekt ose punim të pavarur kërkimor që zbaton teoritë dhe metodologjitë bashkëkohore të menaxhimit.		
Metodat e vlerësimit:	• Projekti Kërkimor: 30% • Provimi Final: 60% • Pjesëmarrja dhe Diskutimet: 10% Në total, nota përfundimtare do të përbëhet nga këto tre elemente kryesore, duke vlerësuar angazhimin dhe aftësitë e studentit në secilën prej tyre.		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ Gareth R. Jones & Jeniffer M. George "Contemporary Management" 12th Edition, Mc Graw Hill, New York, USA 2022. ▪ Samuel C. Certo & S. Trevis Certo "Modern Management – Concepts and Skills" 14th Edition, Pearson Education, USA, 2016. ▪ Ricky W. Griffin "Fundamentals of Management" 10th Edition, Cengage Learning Inc., USA, 2022		
Literatura shtesë:	▪ David M. Boje, Rober P. Gerphart Jr. & Tojo Joseph Thatchenkery "Postmodern Management and Ogranizational Theory" SAGE Publications, USA, 1996. ▪ Richard Daft "Management" 12th Edition, Cengage		

	Learning, USA, 2015.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Sesioni i parë:	Hyrje në Menaxhim, Menaxheri dhe Puna e tij <i>Trajtim i detajuar mbi disiplinën dhe të kuptuarit e Menaxhimit, fushëveprimi, konceptet bashkëkohore, menaxheri, roli, funksioni, aftësitë, profesioni dhe aktivitetet e tij.</i>
Sesioni i dytë:	Mjedisi Menaxherial <i>Studimi, analiza dhe vlerësimi i mjediseve të menaxhimit, trajtimi i mjedisit të largët, diversiteti, shoqëria, qëndrueshmëria, analiza e strukturës, analiza e afërt mjedisore, globalizimi dhe konkurrueshmëria.</i>
Sesioni i tretë:	Planifikimi <i>Planifikimi si koncept dhe mjetet, teknikat drejt të bërit plane, qëllimet dhe objektivat e organizatës, planifikimi strategjik, taktik dhe operacional, menaxheri si planifikues.</i>
Sesioni i katërt:	Organizimi <i>Parimet e organizimit, autoriteti, përgjegjësia, delegimi, struktura organizative dhe dizenet, kultura, menaxhimi i burimeve njerëzore, kontrolli organizativ dhe ndryshimet, menaxhimi i stresit dhe konflikti.</i>
Sesioni i pestë:	Udhëheqja dhe Sjellja Organizative <i>Natyra e udhëheqjes, stilet e udhëheqjes, influenza dhe komunikimi, motivimi dhe performanca, grupi dhe ekipi, ndërtimi i aftësive efektive personale, ndërpersonale dhe konceptuale.</i>
Sesioni i gjashtë:	Konrolli dhe Menaxhimi i Cilësisë <i>Parimet e kontrollit, llojet e kontrollit, kontrolli organizativ dhe ndryshimet, natyra dhe menaxhimi i cilësisë, teknologjitë organizative, menaxhimi total i cilësisë, menaxhimi i produktivitetit.</i>
Sesioni i shtatë:	Vendimmarrja dhe Strategjia <i>Natyra e vendimmarrjes dhe aftësitë vendimmarrëse, të mësuarit dhe kreativiteti, ndërmarresia, llojet e marrjes së vendimeve, natyra e të menaxhimit strategjik, formulimi i strategjisë (nivelet), tipet e analizave strategjike, menaxheri si vendimmarres dhe strategjist.</i>
Sesioni i tetë:	Trendët dhe Qasjet Post-Moderne (Bashkëkohore) në Menaxhim <i>Organizatat mësimore, Mësimi dhe Vetë-Organizimi, Përtej menaxhimi nga burrat (Beyond of Man-age-ment), nga Teknologjia në Ekologji, Dyfishtësia Organizative</i>

	(Ambidiksteriteti).
Sesioni i nëntë:	Prezentimi i punimit hulumtuese

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i>	
• Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.	